

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE BORDI

VENDIME

Gjatë muajit mars Bordi i ERE-s ka zhvilluar 2 mbledhje, që kanë rezultuar në 10 vendimmarrje, ndër të cilat licencimin e një subjekti në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, licencimin e dy subjekteve në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, pezullimin e vendimmarrjes sa i përket shqyrtimit të kërkesës së një subjekti për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në plotësimin e kushteve të paracaktuara, fillimin e procedurës për rinovimin e një licence në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike si dhe disa ndryshime në kushtete e paravendosura në vendimmarrje për dy subjekte të licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Ndër të tjera mund të përmendim gjithashtu:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, të ndryshuar.
2. Miratimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr.186, datë 06.06.2023.
3. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e kushteve të përgjithshme të Kontratës për Diferencë, si parashikim i Nenit 14 i ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.



Për tu njohur me këto vendime në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE

Në datat 7 dhe 8 mars, përfaqësuesit e Entit Rregullator të Energjisë morën pjesë në takimin e përbashkët të Komisioneve të Shoqatës së Rregullatorëve të Energjisë për Rajonin, ERRA "Për Tregun e Energjisë Elektrike dhe Çështjet Ekonomike" dhe "Për Energjinë e Rinovueshme", si dhe në takimin Komisionit për Tregun e Gazit Natyror dhe Çështjet Ekonomike, organizuar në Bratislavë, Sllovaki. Në këto takime, pjesëmarrësit prezantuan sfidat e fleksibilitetit të sistemit elektroenergetik në kontekstin e dekarbonizimit dhe depërtimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, opsionet e krijimit të një rrjeti energjistik fleksibël, modelet e tregut për balancimin, si dhe u diskutua mbi planet e punës për periudhën 2024-2026. Nga përfaqësuesit e ERE-s u prezantua modeli i tregut të energjisë elektrike në Shqipëri dhe zhvillimet e fundit të sektorit.

Në takimin me Komisionin e Gazit Natyror pjesëmarrësit prezantuan studime në lidhje me injektimin e biometanit në sistemin e shpërndarjes, tarifën e shpërndarjes, efektet e transformimit digjital të tregut të gazit natyror etj. Nga ana e përfaqësuesve të ERE-s u paraqit gjendja aktuale e sektorit të gazit natyror në Shqipëri.

SEANCA DËGJIMORE

Gjatë muajit mars, pjesë e aktivitetit të ERE-s kanë qënë dhe seancat dëgjimore me subjekte të licencuar si dhe palë interesi, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo marrjen e qëndrimeve të palëve me qëllim një vendimmarrje më të plotë. Ndër to mund të përmendim një seancë dëgjimore të zhvilluar nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me Albgaz sh.a, e cila në thelb ka patur sqarime dhe diskutime mbi raportin e pajtueshmërisë së subjektit, si dhe një seancë dëgjimore nën drejtimin e Drejtorisë Juridike dhe të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në lidhje me problematikën e krijuar ndërmjet shoqërive OST sh.a., FTL sh.a., dhe Dragobia Energy sh.p.k., mbi njoftimin e kontratës nga shoqëria Dragobia Energy sh.p.k., për shitjen e energjisë elektrike në muajin Mars 2024.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MEDREG

MBROJTJA E KONSUMATORIT

Është përgatitur dhe publikuar së fundmi nga MEDREG – Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë për Mesdheun, një raport për mbrojtjen e konsumatorit nga ERE. Në raport do të lexoni më hollësisht mbi masat që u ndërmorën për të mbrojtur konsumatorët, vulnerabël nga kriza e rritjes së çmimeve të furnizimit me energji elektrike, kanalet e komunikimit të përdorura, mekanizmat e vendosur për të fuqizuar konsumatorët për të marrë vendime të informuara, faturat e energjisë dhe procedurat e ankesave, mbi diversifikimin e burimeve të energjisë dhe përpjekjet e vendosura në vend për të përmirësuar integrimin e tregut rajonal, si dhe mbi sfidat kryesore që has ERE për të mbrojtur në mënyrë efektive konsumatorët në Shqipëri por dhe mbi mbështetjen që MEDREG po ofron në kapërcimin e tyre.



MEDREG

Ky raport është ndërtuar mbi kontributin e përcjellë nga znj. Erjola Sadushi, Komisionere në Bordin e ERE, dhe njëkohësisht nënkryetare e Grupit të Punës së Konsumatorëve pranë MEDREG. Për të shfletuar raportin në gjuhën shqipe ju ftojmë të klikoni në linkun <https://ere.gov.al/sq/publikime/njoftime/raport-fuqizimi-i-rregullatoreve-te-mesdheut-per-nje-te-ardhme-te-perbashket-energjetike> , apo në linkun <https://shorturl.at/ijpr3> për ta shfletuar në faqen zyrtare të MEDREG në gjuhën angleze.

Ju ftojmë gjithashtu të ndiqni Podcastin (<https://soundcloud.com/medreg>) mbi fuqizimin e Rregullatorëve të Mesdheut për një të ardhme energjitike të përbashkët, me kontribut të znj. Sadushi si përfaqësuese e Entit Rregullator të Energjisë.